



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu



III- Nr. i prot. 4058 Më 13.09.2022  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

## KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

### KONTRATË

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 623-22-7666-5-3-6/C409

Emri i Autoritetit Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: N.N.P."VETONI", SOPNIQ, RAHOVEC, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: DRENAZHIMI I FUSHËS SPORTIVE NË SHIML "12 MAJI" NË RATKOC

Me numër identifikues: 623-22-7666-5-3-6

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Drenazhimi i fushës sportive në SHIML "12 Maji" në Ratkoc, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 20 ditë

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: Në fshatin Ratkoc – Komuna e Rahovecit

1.5 Incotermit i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>2</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<sup>2</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **7,379.00 Euro**;

[Shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë Euro e zero Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **737.90 Euro**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **60 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykatën Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]<sup>3</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

| Për Autoritetin Kontraktues: |                                                                                     | Për Kontraktuesin: |                                                                                       |
|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:                        | Astrit Mullabazi                                                                    | Emri:              | Arton Thaqi                                                                           |
| Pozita:                      | Menaxher i Prokurimit                                                               | Pozita:            | Drejtor                                                                               |
| Nënshkrimi:                  |  | Nënshkrimi:        |  |
| Data:                        | 13.09.2022                                                                          | Data:              | 13.09.2022                                                                            |
| Vula:                        |  | Vula:              |  |

<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Paramasa për drenazhimin e fushës sportive në SHML "12 Maji" në Ratkoc

| Nr.pos.         | Pershkrimi i pozicionit                                                                                                                                                 | Njesia         | Sasia | Çmimi   | Shuma     |
|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------|---------|-----------|
| 1               | Gërmimi i dheut te kategorise se trete per hapjen e themeleve, ngarkimi dhe transporti ne deponi ne largesi deri ne 3 km.                                               | m <sup>3</sup> | 49    | 2.0 €   | 98.0 €    |
| 2               | Furnizimi, transporti dhe betonimi i themelit shiritor me beton te markes MB 25Mpa, ne qmim te llogaritet edhe armimi me armature gjatesore fi 12mm dhe me stafa fi8mm. | m <sup>3</sup> | 18.5  | 120.0 € | 2,220.0 € |
| 3               | Furnizimi, transporti, latimi dhe betonimi i murit rrethues me beton te markes MB 25Mpa, ne qmim te llogaritet edhe armimi me armature rrjete Q335.                     | m <sup>3</sup> | 10.5  | 120.0 € | 1,260.0 € |
| 4               | Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave drenazhues te perforuar me diameter Ø110mm, lidhja ndermjet tyre dhe lidhja e tyre ne pusetat e aferta.                      | m'             | 444   | 2.5 €   | 1,110.0 € |
| 5               | Furnizimi, transporti dhe montimi i pusetave kontrolluese se bashku me kapak ne 4 anet e fushes. Pusetat te jene prej PVC-je me dim. 60x60x60cm.                        | copë           | 4     | 80.0 €  | 320.0 €   |
| 6               | Furnizimi, transporti, rrafshimi dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion fr.(16-32)mm                                                                                       | m <sup>3</sup> | 173   | 7.0 €   | 1,211.0 € |
| 7               | Furnizimi, transporti, rrafshimi dhe ngjeshja e reres me fraksion fr.(8-16)mm                                                                                           | m <sup>3</sup> | 58    | 9.0 €   | 522.0 €   |
| 8               | Furnizimi, transporti, rrafshimi dhe ngjeshja e reres me fraksion fr.(4-8)mm                                                                                            | m <sup>3</sup> | 58    | 11.0 €  | 638.0 €   |
| Gjithsej Punet: |                                                                                                                                                                         |                |       |         | 7,379.00  |

Çmimi duhet të jetë konformë të gjitha tatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës

